



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 595/2 prot.

Tiranë, më 24 . 04. 2024

V E N D I M

Nr. 106 , datë 24. 04 .2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi², është regjistruar ankesa nr. 80 Regj, datë 15.04.2024, e paraqitur nga z. Gj.Sh, kundër znj. A.Ll, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me pretendimin për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisioneri, ankuesi parashtron ndër të tjera se, znj. Ll.e njeh prej shumë vitesh, sepse ka qenë palë në shumë seanca gjyqësore, pothuajse të gjitha të lidhura me çështje pronësie. Në gjithë këto vite, nuk kujton të ketë fituar një gjyq të vetëm me këtë gjyqtare. Gjithmonë ka patur përshtypjen që zonja Ll.ka një lloj antipatie për të, por nuk e ka mësuar kurrë shkakun. Në këndvështrimin e ankuesit, gjyqtarja ka qenë e njëanshme në çdo gjyq, duke e nxjerrë humbës, gjë që ka ndikuar shumë tek ai. Ankuesi parashtron disa ngjarjeve, të cilat sipas tij kulmojnë me diskriminimin e hapur që zonja Ll.ka kryer ndaj ankuesit.

Ankuesi parashtron se, më datë 12.07.2016, ka bërë një kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për vendosje mase “sigurim padie”. Pas shortit gjyqtare e çështjes është caktuar znj.A.Ll. Më datë 13.07.2016, gjyqtarja ka vendosur rrezimin e kërkesës së paraqitur nga

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

ankuesi. Më vonë, ankuesi informon se, ka bërë ankesë kundër gjyqtarës në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Inspektoriat i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka verifikuar ankesën e tij ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, znj.A.Ll për “mosrespektim formal të ligjit”, lidhur me mosarsyetimin në kohë të vendimit të çështjes civile. IKLD –ja ka arritur në përfundimin se është kryer shkelje. Sipas ankuesit, ky vendim i IKLD-së ka nxitur edhe më shumë znj.Ll.kundër meje.

Më datë 11.03.2022, unë deklaron se, ka dorëzuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër një kërkesë-padi me objekt sigurim padie dhe deklarimin e pavlefshërisë se veprimeve përmbarimore. Më datë 04.07.2022 ankuesi deklaron se ka depozituar një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës Llazari, për shkak të njëanshmërisë së saj, kërkesë kjo që më është refuzuar.

Më datën 14.07.2022, ankuesi deklaron se është larguar nga salla e gjyqit, sepse znj.Ll.rrëzoi kërkesën e tij për “përfitim të ndihmës juridike detyësore” dhe çështja u pushua.

Më datë 07.07.2022, një javë para gjyqit të fundit me znj.Llazari, ankuesi shpjegon se ka plotësuar një formular aplikimi për “Përfitim të ndihmës juridike detyësore”, pasi kishte nevojë për përfaqësim në gjyq dhe ishte i pamundur ekonomikisht që të mbulonte shpenzimet. Mbështetur në ligjin 111/2017, ndihma juridike parësore dhe detyësore iu ofrohet personave me pamundësi ekonomike dhe kategorive të veçanta, ku bën pjesë edhe ai, si invalid i grupit të dytë.

Ankuesi pretendon se, znj. Ll.e ka diskriminuar duke i mohur një të drejtë që garantohet me ligj. Ky diskriminim, i cili në këtë moment u shfaq dukshëm, duke mos lënë asnjë dyshim, shkaktoi një tronditje të madhe psikike tek ai, aq sa u largua nga salla e gjyqit pa u mbrojtur, gjë që i kushtoi edhe nga ana ekonomike, pasi shuma për të cilën ai kërkoi heqjen e sekuestros vazhdon të jetë e bllokuar. Ndonëse njohëse e mirë e ligjeve, znj.Ll.i ka bërë të pamundur ushtrimin në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave dhe lirive themelore të njohura me Kushtetutën e republikës së Shqipërisë. I tillë është edhe ligji 111/2017, i cili garanton ndihmë ligjore për personat e pamundur ekonomikisht dhe kategoritë e veçanta. Mbështetur në të njëjtin ligj, një tjetër gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër e ka pranuar kërkesën e ankuesit për ndihmë juridike detyësore.

Ankuesi informon gjithashtu se, mbështetur në lidhin 111/2017, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë më datë 28.09.2021, i ka pranuar kërkesën për ndihmë juridike shtetasit A.M; Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër më datë 14.01.2021, i ka pranuar kërkesën për ndihmë juridike shtetasit F.Ç; Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër më datë 20.01.2022, i ka pranuar kërkesën për ndihmë juridike shtetasit M.P; Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pogradec, më datë 19.01.2022, i ka pranuar kërkesën për ndihmë juridike shtetasit P.Gj; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë më datë 23.12.2021, i ka pranuar kërkesën për ndihmë juridike shtetasit J.D. Sipas ankuesit rastet e mësipërme, rikonfirmojë pretendimet e tij se është

diskriminuar nga gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, sepse individët e përmendur më sipër janë invalidë që kanë përfituar ndihmë juridike falë ligjit 111/2017

Ankuesi deklaron se gjyqtarja A.LI ka qenë e njëanshme në gjykim dhe pretendon se është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri hetimin e rastit të tij, konfirmimin apo gjetjen e shkakut real të diskriminimit. Marrjen e masave ndaj subjektit kundër të cilit ka paraqitur ankesën, duke përfshirë dëmshpërblimin financiar për pasojat ekonomike të pësuarat si pasojë e diskriminimit, sipas ligjeve përkatëse.

Në datën 19.04.2024 (administruar me nr.595/1 prot), ankuesi ka depozituar pranë Komisionerit një ankesë me të njëjtat pretendime.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të LMD, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të

shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi, Komisioneri konstaton se:

Ankuesi, ka ngritur pretendime ndaj sistemit të drejtësisë, dhe konkretisht kundrejt znj. A.LI, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për dhënien e një vendimi të pabazuar në ligj në lidhje me kërkesën e paraqitur prej tij sipas ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” për përfitimin e ndihmës juridike dytësore³. Ankuesi ka parashtruar se kërkesa e tij është pranuar nga një tjetër gjyqtar pranë kësaj gjykate dhe se në mënyrë të ngjashme persona të tjerë në të njëjtën gjykatë ose në gjykata të tjera, kanë përfuturuar ndihmë juridike dytësore.

Lidhur me kërkesën e paraqitur nga ankuesi, që Komisioneri, të konstatojë diskriminim të tij, lidhur me vendimmarrjen e pabazuar në ligj dhe të njëanshme në dëm të interesit të tij, nga ana e znj. A.LI, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Komisioneri, vëren se, kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për rrjedhojë, Komisioneri nuk mund të vlerësojë vendimmarrjen e gjyqtarës kundër të cilës ankuesi ka paraqitur ankesën.

Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: “*Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës*”.

Në vendimin nr. 11, datë 27.05.2004, të Gjykatës Kushtetuese⁴, ndër të tjera, thuhet se: “*Në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, është përcaktuar se: “...vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta”. Pra, meqenëse ky pushtet ushtrohet në mënyrë të shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, asnjë organ tjetër, nuk ka të drejtë të kontrollojë e vlerësojë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mospërfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Duke iu referuar praktikës së saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se, vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, e se, asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë*”.

³ Sipas nenit 3, germa “c”, të ligjit nr.111/2017, ndihma juridike dytësore është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.

⁴ “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, në nenin 132, të saj, ka përcaktuar se: “*Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim*”.

Neni 135, pika 1 e Kushtetutës, bën dallimin midis gjyqtarëve sipas funksioneve dhe në të njëjtën kohë kërkon t'i shkëpusë ata nga varësia hierarkike dhe ia nënshtrohen veprimtarinë e tyre në dhënien e drejtësisë, vetëm kontrollit të instancave më të larta gjyqësore, sipas rregullave të përcaktuara në kodet e procedurave.

Në nenin 145, të Kushtetutës, sanksionohet se, gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke nënkuptuar kështu, pavarësinë, përgjegjësinë dhe kompetencat e veçanta të gjyqtarit në dhënien e drejtësisë, nëpërmjet vendimmarrjes së çështjes konkrete. Asnjë pushtet apo organ tjetër nuk mund të veprojë si gjykatë dhe të marrë kompetencat e saj.

Komisioneri vlerëson se, nëse ankuesi nuk është dakord dhe ka pretendime lidhur me vendimmarrjet e cilësdo gjykatë, duhet t'i drejtohet gjykatës më të lartë dhe lidhur me pretendimet për anësi apo pretendime të natyrës profesionale apo etike mund t'i drejtohet Këshillit të Lartë të Gjyqësor⁵ apo Inspektorit të Lartë të Drejtësisë⁶, të cilët janë organet kompetente të caktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për shqyrtimin e tyre.

Pretendimet e ankuesit mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor, ankimimit përpara gjykatave të shkallëve më të larta. Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit dhe për sa kohë nuk janë prishur apo ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjykatën apo gjyqtarin e çështjes që e ka shqyrtuar.

Në pikën 7 dhe 8, të nenit 22 “*Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë juridike detyësore nga gjykata*”, përcaktohet shprehimisht se: “7. *Kundër vendimit të gjykatës për rrëzimin e kërkesës për ndihmën juridike detyësore mund të bëhet ankimi i veçantë. Ankimi i vendimit nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të çështjes. Ankimi bëhet sipas formularit tip të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, i cili i jepet kërkuesit së bashku me vendimin për rrëzimin e kërkesës. 8. Gjykata e apelit shqyrton çështjen në dhomë këshillimi dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë.*”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim dhe kontrolli i vendimeve të gjykatës dhe prokurorisë, nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit, e për pasojë nuk mund

⁵ Neni 147/a, i Kushtetutës, përcakton ndër të tjera, se: “*Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme:*
a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;
b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve”.

⁶ Neni 147/d, i Kushtetutës, përcakton ndër të tjera, se: “*Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë*”.

të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁷.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankuesit për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së paraqitur nga ankuesi Gj.Sh, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar, çdo shkak tjetër

Fusha: Të mira dhe shërbime

Lloji i vendimit: Mospranim_Jashtë kompetence

⁷ Për analogji citojmë Vendimin nr. 02, datë 11.01.2021 dhe vendimin nr.19, datë 17.01.2022, të Komisionerit